

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT VJETOR 2018

Përgatitur për

MBLEDHJEN E **XI-të** TË KUVENDIT TË STIKK



28 shkurt 2019


Ora 09:00 në **Hotel Garden**, Prishtinë

Anëtarët e artë 2018/2019



Anëtarët e argjendtë 2018/2019





Anëtarët

4
B2B Takime

Symposium Berlin (GER),
B2B Nuremberg (GER),
metal Përpunues dhe
energji të ripërtëritshme
(KIMERK), dhe KosICT

Strategjik Thinking,
Android, dhe
C#

3
Trajnime

STIKK EDUCATION

10
Konferenca
& Panaire

KOSICT

4
Business Leads

13
Takime dhe
grupe punuese

1
Publikim

Barometri i TI
për Kosovë 2018

2018

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjate periudhës së njëvjeçare të vitit 2018 janë realizuar aktivitete të cilat janë në përputhshmëri me pesë (5) objektivat e STIKK:

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK

Nën objektivin e parë të strategjisë së STIKK janë ndërmarr aktivitete të cilat mbështesin rritjen e sektorit të TIK. Disa nga aktivitetet me ndikim më të madh në saje të objektivës janë: *Organizimi i takimeve për rishikim të Strategjisë për TI, Përfundimi i planit detal, inicimi i fazës së tenderimit dhe faza e parë e punimeve në TechPark, si dhe Prezantimi publik i Barometrit të TI-së 2018.*

Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut

Nën objektivin e dytë, zhvillimi i burimeve njerëzore ose zhvillimi i fuqisë punëtorë në TIK është njëra prej shtyllave kryesore për një rritje të qëndrueshme të sektorit. Disa nga aktivitetet për këtë vit janë: *Organizimi i punëtorisë në "Strategic Thinking", Mbarëvajtja e praktikës profesionale të grupit 3-të të STIKK Education, si dhe trajnimet dhe faza e zhvillimit të grupit të 4-të të STIKK Education.*

Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore

Objektivi i tretë ku caku është krijimi dhe zhvillimi i mundësive biznesore për anëtarët duke fuqizuar dhe zgjeruar rrjetin biznesor të tyre. Disa prej aktivitete që mbështesin këtë objektivë janë: *Lansimi i projektit të ri të GIZ – Creating Employment through Export Promotion (CETEP), Tryezë e rrumbullakët diskutimi rreth mundësive dhe sfidave me të cilat po ballafaqohen kompanitë kosovare gjatë eksportimit të shërbimeve të TI, Organizimi i takimeve B2B me sektorë të tjerë, Pjesëmarrja në Symposiumin nga BME në Berlin, Organizimi i B2B takimeve në Nuremberg, si dhe Organizimi i edicionit të 7-të të KosICT.*

Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

Objektivi i katërt ku krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme u mbështet nga këto aktivitete: *Kuvendi i X-të i STIKK, si dhe aplikimi dhe aprovimi i projekteve në thirrje të ndryshme.*

Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

Objektivi i pestë - mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK u mbështet nga ky aktivitet: *Dhurimi vullnetar i gjakut.*

Publikimet gjatë vitit

- Studimi "Barometri i TI për Kosovë 2018":

[https://stikk.org/wp-content/uploads/2018/12/Publications_2018 - IT Barometer SQ.pdf](https://stikk.org/wp-content/uploads/2018/12/Publications_2018_-_IT_Barometer_SQ.pdf)

Mbledhjet e bordit

Gjatë vitit 2018 u mbajtën gjithsej **5 mbledhje të Bordit** të STIKK, 4 të rregullta (5 shkurt, 8 maj, 17 korrik, dhe 3 tetor) dhe 1 e jashtëzakonshme (23 prill).

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

STIKK ka angazhuar 4 Asistent, 2 prej tyre në zyrën e Menaxhimit të Projekteve dhe 2 në Zyrën e Administratës dhe Financave. Gjithashtu janë angazhuar 3 praktikantë në Shkurt, Tetor dhe Nëntor. Gjatë 2018 STIKK ka pranuar një dorëheqje nga një asistent i Projekteve.

Anëtarët e STIKK

Gjatë këtij viti janë bërë **10** anëtarësime të reja në STIKK: **Ornio** (Janar 2018), **Mikgroup** (Janar 2018), **Starlabs** (Mars 2018), **Sogody** (Prill 2018), **Financial Core** (April 2018), **Adaptech** (Maj 2018), si anëtarë të Bronztë, **Coda Tech** (Prill 2018) si anëtar Startup, pastaj upgrade në anëtar i Bronztë, **Novus** (Korrik 2018) **designvox** (Nëntor 2018), si anëtarë të Argjentë, si dhe **Docman** (Gusht 2018) si anëtar Bashkëpunues. **8** kompani janë tërhequr nga anëtarësimi në STIKK në 2018: **BEO**, **Bit Kosova**, **Milingona**, **ABIDAT**, **TeraBIT**, **Kdynamic**, **ZAG APPS** dhe **ITD Prishtinë**.

Në fund të vitit, STIKK ka në total **55 anëtarë** (45 kompani anëtarë, 10 anëtarë bashkëpunues, 0 profesionist/student).

Të hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2018, të hyrat e STIKK ishin **211,231.23 €** (12,40% më pak krahasuar me 239,165.00 € të vitit 2017), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej **231,751.92€** (3,30% më pak krahasuar me 239,551.00 € në vitin 2017).

Auditimi i financave të STIKK

Kompania audituese e pavarur "Grant Thornton", e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK në Mbledhjen e Kuvendit 2016, do të bëjë auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare të STIKK për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018. Ky auditim do të realizohet gjatë muajit Shkurt.